

në Çubrel/Çubrelj. E varrosën një ditë më vonë në varrezat e Radishevës/Radiševo. Familjarët e Kapllanit kanë mësuar në muajin nëntor të të njëjtit vit se pjesëtarë të forcave serbe e kanë çuar trupin e Kapllanit në spitalin e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, ndërkaq e kanë varrosur më vonë në varrezat në pjesën veriore të qytetit, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata I.A, FDH-32459; deklarata S.S, FDH-6780; deklarata V.T, FDH-18998; SHFDUÇK, *Fenikset...5*, 149-152; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Bodies of Three Slain Albanians Found on Thursday*, pasqyra e lajmeve, KIC, 30.10.1998, FDH-29783; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex. 6D00614, FDH-35527.

Fetije (Sefer) Koca

(15.01.1983, shqiptare nga Polaci/Poljance, komuna e Skënderajt/Srbica)

Shtëpia e familjes së Fetijes gjendej pranë rrugës kryesore Skënderaj/Srbica – Gllagog/Glogovac, në Polac/Poljance. Fetija ishte shurdhmemecë dhe vuante nga epilepsia. I përjetonte shumë rëndë granatimet dhe krismat. Në mbrëmje, më 6.08.1998, kur filloi gjëmimi i rëndë i armëve të zjarrit nga drejtimi i Qirezit/Ćirez, Fetija u shqetësua shumë. Por, familjarët e qetësuan disi dhe e futën në gjumë. Të shtënat dëgjoreshin tërë natën, ndërkaq herët në mëngjes, më 7.08.1998, familjarët kuptuan se ajo nuk gjendej në krevatin e saj. Nisën ta kërkonin. Tri vajza nga fshati i kanë thënë vëllait të Fetijes, Brahimit, se e kishin vërejtur Fetijen këmbëzbathur duke shkuar drejt kodrës në lagjen *Xani* [Polac/Poljance], ku ishin të stacionuara forcat serbe. Pas pak, nga ai drejtim u dëgjuan të shtënat. Për shkak të situatës së rrezikshme të sigurisë, familjarët nuk guxuan të shkolinin në atë drejtim për ta kërkuar Fetijen. Një ditë më vonë, e kanë paraqitur rastin e saj në policinë e Gllagogit/Glogovac. E kërkuan edhe përmes mediave. Rastin e saj e kanë paraqitur edhe te shumë organizata, por nuk kanë mësuar asgjë për fatin e Fetijes deri më sot. Në regjistrin e KNKK-së për persona të zhdukur, rasti i saj është evidentuar në dosjen me numër BLG-803822-01.

Burimet: deklarata A.K, FDH-20339; deklarata B.K, FDH-2767; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; *Serb Infantry Sets Ablaze Farmsteads in Polac, Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 07.08.1998, FDH-29405.

Hasan (Imer) Baliu

(20.06.1936, shqiptar nga Turiqeci/Turićevac, komuna e Skënderajt/Srbica, murator, gjashtë fëmijë)

Hasani me bashkëshorten Zylen, djalnin Ramadanin dhe të rejën jetonin në shtëpinë familjare në Turiqec/Turićevac. Forcat serbe e nisën bombardimin e fshatit herët në mëngjes më 4.08.1998. Hasani me familje u strehuan në pyll përmbi Aqarevë/Ovçarevo, ku gjendej edhe një numër i madh i refugjatëve të tjerë. Pas katër ditësh, më 8.08.1998, Hasani vendosi të shkonte në Turiqec/Turićevac për ta kontrolluar bagëtinë dhe t'i merrte disa gjësende të nevojshme. Ishte kjo hera e fundit kur e shihnin të gjallë. Tri ditë më vonë, familjarët mësuan se trupin e pajetë të Hasanit e kishin gjetur në livadhin e familjes Abazi, një kilometër larg shtëpisë familjare. Po atë ditë, miqtë e tij e kanë varrosur në varrezat e Turiqecit/Turićevac.

Burimi: deklarata R.B, FDH-17333.

Arben (Fejzë) Smajli

(3.03.1978, shqiptar nga Skënderaj/Srbica, i pamartuar)

Arbeni e ka mbaruar shkollën e mesme për shurdhmemecët. Në fillim të muajit gusht të vitit 1998, Arbeni me prindërit shkuan në Tërstenik/Trstenik [Gllagog/Glogovac], në vizitë te daja i tij, Fehmi Kukani. Në datën 16.08.1998, Arbeni doli nga shtëpia për tu takuar me një mik të shkollës. Menjëherë pas daljes së tij, forcat serbe e kanë sulmuar fshatin. Vendasit filluan të largoheshin nga fshati. Arbeni nuk ka mundur të kthehet, por u nis vetë drejt Skënderajt/Srbica. Familjarët kanë mësuar po atë ditë se policia serbe e kishte vrarë Arbenin në fshatin *Marinë/Marina* dhe se e kanë varrosur pranë pyllit. Përveç dheut, varri i tij ishte i mbuluar edhe me gjethet. Ditën e nesërme, babai dhe vëllai i Arbenit e kanë gjetur varrin. E kanë hapur dhe në